

SJELLJA KONSUMATORE DHE PRITSHMËRITË E BIZNESEVE PËR PERIUDHËN POST COVID – 19

Qershor 2021



Contents

PËRMBLEDHJE.....	3
Hyrje	3
Qëllimi.....	3
Metodologjia.....	3
Gjetjet kryesore (Të ndara sipas pyetjeve)	4
Profili i kompanive	4
TË ARDHURAT DHE EFEKTI I COVID 19	6
PËRDORIMI I PRODUKTEVE FINANCIARE DHE NEVOJA PËR FINANCIM	10
NJOHSHMËRIA E INDUSTRIË SË MIKROFINANCËS DHE PËRDORIMI I SAJ	11
REPUTACIONI I INDUSTRIË	13
PËRFUNDIME	16



PËRMBLEDHJE

Ky raport përmbledh gjetjet të studimit me tematikën – SJELLJA KONSUMATORE DHE PRITSHMËRITË E BIZNESEVE PËR PERIUDHËN POST COVID – 19. Studimi është zhvilluar gjatë muajve Maj-Qershor 2021 dhe është shpërndarë në të gjithë aktorët e mikrofinancës pavarësisht shërbimit që ata ofrojnë si dhe për të kuptuar realisht të gjitha pritshmëritë e qytetarëve Shqiptar për periudhë e sapo kaluar dhe pasojat që ajo ka lënë në sjelljen e tyre si konsumatorë.

Në total kemi 9 aktorë të industrisë së mikrofinancës të cilët kanë shprehur opinionin e tyre dhe 177 biznese, pra përdorues të këtyre shërbimeve.

Hyrje

Gjatë muajit Maj – Qershor 2021 9 kompani aktore të industrisë së mikrofinancës kanë plotësuar pyetësin në lidhje me efektet e pandemisë tek klientët që ata shërbejnë dhe sjelljen e tyre konsumatore në vazhdim. Këta individë kanë shprehur jo vetëm pritshmëritë e tyre në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e tyre por edhe për shërbimin dhe opinionin e tyre për aktorët e mikrofinancës në Shqipëri.

Qëllimi

Ky pyetësor do të shërbejë jo vetëm që aktorët e mikrofinancës të kenë mundësi për të shërbyer me produkte më të personalizuar klientët e tyre por dhe të kenë mundësi të përmirësojnë shërbimin e tyre apo përpjekjet për edukim të këtij target grupi sipas nevojave specifike që secili nga individët ka.

Metodologjia

1. Pyetësori përbëhet nga 5 seksione kryesore
 - a. Profili i individëve të marr në pyetje
 - b. Si ka ndikuar Covid-19 në të ardhurat e tyre
 - c. Cilat janë pritshmëritë e tyre për shpenzimet në të ardhmen
 - d. Përdorimi i produktit që ofrojnë kompanitë e mikrofinancës
 - e. Njohshmëria e tregut dhe opinionin e individëve për shërbimin e marrë

1. Janë intervistuar gjithsej 177 klientë të këtyre aktorëve.


Afati i mbledhjes së të dhënave: **Qershor 2021**




Gjetjet kryesore (Të ndara sipas pyetjeve)

Profili i kompanive


Rajoni ku ushtrohet




VITE NË AKTIVITET




FUNKSIONI I TË INTERVISTUARIT



MADHËSIA E BIZNESIT



FUSHA E AKTIVITETIT



*) This activity has received financial support from the European Union Programme for Employment and Social Innovation "EaSI" (2014-2020). For further information please consult: <http://ec.europa.eu/social/easi>




40% e bizneseve të intervistura kanë 5 ose më pak vjet në treg, 14% e tyre 5-10, 36% 10-20 vjet aktiviteti. Shumica e biznese të intervistuar janë në Tiranë (35% e tyre) por shpërndarja e bizneseve të intervistuar është në pjesën më të madhe të qyteteve të Shqipërisë. Çka e bën këtë studim të përfaqësueshëm në nivel kombëtar.

Pjesa më e madhe të të intervistuarve janë ose pronar ose administrator, çka tregon për kompani të vogla shpesh me të menaxhuar në nivel familjar. Të njëjtën gjë na vërteton dhe grafiku më pas, ku shohim se 90% e bizneseve janë me më pak se 9 punonjës.

Këto kompani kryesisht operojnë në bujqësi, peshkim dhe agro përpunim, hoteleri dhe shërbime akomodimi, kafene dhe bar restaurante, shërbime ndaj individëve (këpucar, dentist, rrobaqepës, pastrim kimik etj), transport dhe tregëti me pakicë.


TË ARDHURAT DHE EFEKTI I COVID 19

Çfarë keni vënë re ju dhe biznesi juaj në 12 muajt e fundit në lidhje me fitimin?




69% të të intervistuarve kanë vënë re një rënie në të ardhurat e tyre gjatë 12 muajve të fundit, si rezultat i situatës së krijuar në vend nga Covid 19. 15% të të intervistuarve deklarojnë se të ardhurat e tyre kanë mbetur të njëjtat, dhe gjithashtu 15% kanë dëshmuar rritje të të ardhurave.

Deri në çfarë mase pandemia Covid-19 ka ndikuar në fitimin e biznesit tuaj?




Ashtu siç pamë dhe në grafikun e mësipërm nivelet e ndikimit në të ardhurat e individëve mbeten të njëjta. 79% e të intervistuarve deklarojnë se pandemia ka patur ndikim negativ dhe disi negativ në të ardhurat e tyre. Vetëm 11% duken se nuk kanë qënë të ndikuar dhe kanë ndenjur në të njëjtat nivele dhe rreth 10% kanë patur ndikim pozitiv.

Si prisni që të ardhurat tuaja të ndryshojnë në 12 muajt e ardhshëm



Është e vështirë nga ana e të intervistuarve (rreth 41%) të parashikojnë se si do të jenë të ardhurat e tyre. 42% e të intervistuarve mendojnë se ato do të rriten, 15% mendojnë se të ardhurat do të qëndrojnë të njëjta dhe vetëm 2% mendojnë se do t'u ulen.

Si ja ka dalë ekonomikisht kompania juaj në 12 muajt e fundit?




75% e të intervistuarve kanë hasu vështirësi financiare dhe ata kanë ndërrmarë shkurtime në shpenzimet e tyre për të arritur që të manovrojnë me të ardhurat që ata kanë si dhe largimit të punonjësve nga puna.

13% të kompanive të intervistuarra kanë arritur të që të manovrojnë me të ardhurat që kompania ka gjeneruar dhe të mos marrin kredi. 18% e tyre ja kanë dale por pa patur mundësi të gjenerojnë fitim, dhe vetëm 22% e kompanive të intervistuarra kanë arritur të gjenerojnë fitim pas të gjitha shpenzimeve.




Cilat janë gjasat që në 6 muajt e fundit ju do të investoni në:



Të intervistuarit janë shprehur se ata mund të zgjedhin të investojnë nëpërmjet kredisë në 6 muajt që vijnë për të rritur biznesin e tyre. 55% e quajne disi të mundur ose të mundur që ata të investojnë për të rritur likuiditetin. 55% mendojnë se mund të investojnë për trajnime dhe këshillime që do ti ndihmojnë për të rritur shitjet. 52% mund të investojnë në procese, 55% mund të investojnë në makineri dhe pajisje, dhe 89% do të investonin për të përmbushur nevojat e kompanisë cilado të jetë kjo nevoja.


A keni keni marrë mbështetje nga shteti gjatë 12 muajve të fundit (në lidhje me bllokimin e lëvizjes për shkak të COVID-19)?



63% e bizneseve nuk kanë marrë një mbështetje nga shteti gjatë 12 muajve të fundit. Ata i kanë përballuar vetë të gjitha pengesat dhe shpenzimet që kanë ardhur gjatë këtyre muajve.

PËRDORIMI I PRODUKTEVE FINANCIARE DHE NEVOJA PËR FINANCIM



Cilin nga këto shërbime financiare keni përdorur si biznes në 3 vitet e fundit për të mbuluar nevojat tuaja?



Duket se kreditë bankare janë ende të parat në listen e të intervistuarve sa here që ata kanë nevojë për para. Megjithatë kreditë jo bankare janë në vend të dytë si zgjedhje e konsumatorëve për të zgjidhur nevojat e tyre financiare (46%). Ndërkohë duket se borxhi tek të afërmit nuk pëlqehet si zgjidhje.


NJOHJA E INDUSTRIË SË MIKROFINANCËS DHE PËRDORIMI I SAJ

Ju lutem na thoni se ku mund te merrni nje kredi te vogel te shpejte per biznesin?



Në këtë pyetje të hapur (njohje pa ndihmë) shohim se Fondi Besa është institucioni që vjen I pari në mend si një institucion që mund të marrësh kredi të vogla, I pasuar nga NOA dhe AgroSocial Fund. Në të njëjtat nivele janë dhe njohshmëria për logon e tyre, kur të intervistuarit janë paraqitur vizualisht me logot e tyre.

Në cilin institucion e keni marrë kredinë tuaj të fundit të vogël në 12 muajt e fundit?




37% të të intervistuarve deklarojnë se kanë marrë një kredi pranë NOA kohët e fundit, pasohet nga 36% në Fondi Besa, 11% tek Agro Social Fund.

REPUTACIONI I INDUSTRIË


Në këtë pjesë të pyetësorit të intervistuarit u kërkuan që të jepnin mendimin e tyre për kompanitë të cilat merrnin pjesë. Në këtë seksion do të vendosim përgjigjet për ato kompani që ka patur mjaftueshëm të intervistuar për të krijuar një opinion asnjëanës.

Agro & Social Fund



Pikat e forta të Agro Social Fund janë dhënia e informacionit të duhur tek klientët, ata ikin të sigurtë kur largohen nga ambientet e këtij institucioni. Gjithashtu klienti e vlerëson kontaktin që punonjësit kanë me ta dhe informacioni që i japin. Ndërkohë Agro & Social Fund duhet të bëjë më shumë për edukimin financiar si dhe të jape mundësi më fleksibël për pagesat e kështit kur klientët janë në vështirësi.


Fondi Besa



Pikat e forta të Fondi Besa janë dhënia e informacionit të duhur tek klientët, ata ikin të sigurtë kur largohen nga ambientet e këtij institucioni. Gjithashtu klienti e vlerëson kontaktin që punonjësit kanë me ta dhe informacioni që i japin. Ndërkohë Fondi Besa duhet të bëjë më shumë për edukimin financiar si dhe të jape mundësi më fleksibël për pagesat e këstit kur klientët janë në vështirësi si dhe të japë më shumë opsione për kohëzgjatjen e kredive.



NOA



Pikat e forta të NOA janë dhënia e informacionit të duhur tek klientët, shpejtësia e dhënies së kredisë dhe shërbimi në degë. Gjithashtu klienti e vlerëson kontaktin që punonjësit kanë me ta dhe informacioni që i japin. Ndërkohë NOA duhet të bëjë më shumë për edukimin financiar si dhe të bëjë më shumë për komunitetin si dhe të japi mundësi më fleksibël për kohëzgjatjen e kredisë.



PËRFUNDIME

- Bizneset e vogla dhe mikrondermarrjet kaluan nje periudhe shume te veshtire gjate pandemise
- Ne shumicen e rasteve te ardhurat dhe fitimi rane ne menyre te ndjeshme, dhe ata u detyruan te shkurtojne kostot dhe te drejtohen prane institucioneve financiare per te marre kredi. Pothuajse gjysma e kompanive u detyruan te merrnin hua per te mbuluar shpenzimet, nderkohe qe nje e pesta duhet te reduktonte shpenzimet apo personelin
- Ekziton ende nje pasiguri e larte ne lidhje me situaten ekonomike dhe ecurine e saj. Me shume se 40% e te anketuarve nuk jane te qarte se si do te jete kjo ecuri
- Megjithate, nje pjese po kaq e madhe shprehen optimiste dhe kane pritshmeri qe situata e veshtire do te kaloje pa nje perkeqesim te metejshem
- Klientet konsiderojne kanalet bankare si burimin paresor te kredimarrjes me 60% te te anketuarve, dhe kanalet e mikrofinanses si burimin dytesor me 36%
- Shumica e bizneseve te vogla dhe mikrondermarrjeve te intervistuar deklarojne qe nuk kane marre ndihme nga shteti, pavaresisht dy skemave te garancive sovrane te dizenuara dhe vena ne dispozicion per biznesin

